



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:081821
Datë: 15.05.2024
Numri i dokumentit: 05688042

Ac.nr.8615/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryetar i kolegjit, Fatmir Baloku e Besnik Bislimaj - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit L.N nga Gj....., të cilin me autorizim e përfaqëson av.F.S nga Gj....., kundër të paditurës Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë me objekt kontesti pagesën e shpërblimit jubilar, vlera e kontestit€, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - departamenti i përgjithshëm, C.nr.572/21, të datës 31.10.2022, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datën **15.05.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - departamenti i përgjithshëm, C.nr.572/21, i datës 31.10.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, C.nr.572/21, të datës 31.10.2022, në pikën *I (një)* të dispozitivit e ka aprovuar të bazuar kërkesëpadinë e paditësit L.N nga Gj.... dhe e ka detyruar të paditurën Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë, që paditësit të lartcekur, në emër të shpërblimit jubilar të ia paguajë vlerën e tre pagave bazë dhe atë shumë prej 2,797.92.-€ (dymijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë euro e nëntëdhjetë e dy cent) me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të fillojë të llogaritet nga data 26.04.2021 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm. Në pikën *II (dy)* të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që në emër të pagesës për shpenzimet e procedurës, paditësit të ia paguajë shumë prej

144.00.-€, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të *vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike*, me propozim që Gjykata e Apelit ta hedhë poshtë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.572/21, të datës 31.10.2022 dhe ankesën e të paditurës ta aprovon si të bazuar.

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurës.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës të nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes të autorizuarit të tij, me datën 26.04.2021, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për kompensimin e pagave në emër të shpërblimit jubilar, kundër të paditurës, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, jashtë seancës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.572/21, të datës 31.10.2022, me të cilin e ka aprovuar të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decisivisht si në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura si Doktor Specialist – Shef i Kabinetit Neurologjik dhe ka gjithsej 30 vite përvojë pune dhe se paga bazë e tij është në vlerë prej 944 euro. Këto fakte i ka vërtetuar përmes provave siç janë: Kontrata e punës për paditësin me numër ,,,,, e datës 03.01.2013, Vërtetimi i marrëdhënies së punës e lëshuar nga e paditura me datë 26.01.2021, Lista e pagës e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për periudhën 01.03.2021-31.03.2021. Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit 17 par. 3, nënpar.3.3 dhe nenit 17.4 të Marrëveshjes Kolektive Sektoriale. Sa i përket kamatës gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur në bazë të nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadsisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe disa fakte vendimtare nuk kanë qenë kontestuese. Nuk ka qenë kontestuese në mes palëve se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura si Doktor Specialist - Shef i Kabinetit Neurologjik gjë që vërtetohet përmes kontratës së punës me numër ,, e datës 03.01.2013 dhe se i njëjti ka përvojë pune 30 vite. Kjo rrethanë është provuar edhe nga vërtetimi i marrëdhënies së punës e lëshuar nga e paditura me datë 26.01.2021 nga ku vërtetohet fakti se paditësi vitin jubilar prej 30 vite të përvojës së punës e ka arritur në vitin 2021 në kohën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale e cila ka paraparë beneficinet e shpërblimit jubilar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsye se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212, të datës 01.11.2010, përcaktohet se “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”.

Me nenin 17 par. 3, të Marrëveshjes Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, të datës 11.06.2018, përcaktohet se “*Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: Për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një paga mujore të tij; Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij; Për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij*”. Me paragrafin 4 të kësaj Marrëveshje përcaktohet se “*Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf*”. Andaj mbi bazën e tërë të lartcekurave gjykata e shkallës së dytë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkesëpadsinë e paditësit si të bazuar në tërësi, për çka edhe vendosi që të njëjtin ta vërtetoj sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozita e LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore.

E drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë edhe sa i përket kërkesës aksesore përkitazi me kamatën.

Në këtë drejtim edhe vendimi mbi shpenzimet e procedurës nga gjykata e shkallës së parë është marrë në përputhje të plotë me nenin 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.8615/22, datë 15.05.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari
Arsim Hamzaj